



KPA SHQYRTON ANKIMIN E KOMISIONERIT PUBLIK, NDAJ VENDIMIT TË KPK-SË QË KONFIRMOI NË DETYRË ZNJ. ELONA TORO, GJYQTARE PRANË GJYKATËS SË APELIT TIRANË, PA PRANINË E PUBLIKUT NË SALLË

**RAPORTIM PARAPRAK I SEANCËS DËGJIMORE
DATË 05/12/2022 PRANË KPA:**

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) shqyrtoi ankimin e depozituar nga ana e Komisionerit Publik, ndaj vendimit të KPK, nëpërmjet të cilit ishte vendosur konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit znj. Elona Toro.

Komisionerit Publik kërkoi kryerjen e një analize të re financiare për personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit.

Gjyqtarja Elona Toro kërkoi depozitimin e provave të reja për të mbështetur aftësinë financiare të personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

KPA vendosi riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrim të provave të reja, të depozituara nga ana e subjektit.

Seanca gjyqësore publike u monitorua nga vëzhguesi i KShH-së, nëpërmjet monitorit audio-vizual të vendosur në ambientet e jashtme të sallës së gjyqimit



KPA shqyrton ankimin e Komisionerit Publik, ndaj vendimit të KPK-së që konfirmoi në detyrë znj. Elona Toro, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë

Më datë 05.12.2022, ora 10:10, në seancë gjyqësore publike Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) shqyrtoi ankimin e depozituar nga ana e Komisionerit Publik, ndaj vendimit të KPK, nëpërmjet të cilit ishte vendosur konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit znj. Elona Toro.

Më herët, KPA kishte planifikuar realizimin e seancës gjyqësore publike më dt. 23.11.2022, por për shkak të mos prezencës së një anëtarit të trupës gjyqësore dhe vëzhguesit ndërkombëtar, seanca ishte shtyrë sipas nenit 460 K.Pr.C. dhe 34 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

Seanca gjyqësore publike u monitorua nga vëzhguesi i KShH-së, nëpërmjet monitorit audio-vizual të vendosur në ambientet e jashtme të sallës së gjyqimit. Në nëntor 2022, KShH i është drejtuar KPA nëpërmjet shkresës zyrtare, duke kërkuar rishikimin e Rregullores së Brendshme për përcaktimin e masave kufizuese, në raport me qasjen lehtësuese sociale të rekomanduar nga Komiteti Teknik i Ekspertëve. Në vlerësimin e KShH, transmetimi live i seancave publike të KPA-së për personat e interesuar nuk garanton të njëjtin nivel aksesit dhe rrjedhimisht edhe kuptueshmëri të mbarëvajtjes së procesit dhe vëzhgimit të sjelljes së secilës palë në seancë, si në rastet kur publiku është prezent fizikisht në sallë.

Trupa gjyqësore e përbërë nga z. Sokol Çomo (kryesues), znj. Ina Rama (relatore), znj. Rezarta Schuetz, znj. Albana Shtylla dhe znj. Mimoza Tasi (anëtare), e asistuar nga vëzhguesi ndërkombëtar z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në çelje të seancës gjyqësore nuk relatoi çështjen, sipas nenit 464 të Kodit të Procedurës Civile.

Përfaqësuesi i Komisionerit Publik z. Ballhysa dhe subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e relatuar prej tyre, i qëndruan shkaqeve të ankimit dhe kundër-ankimit të depozituara me shkrim. Më konkretisht, Komisioneri Publik kërkoj kryerjen e një analize të re financiare për personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit, konkretisht babai i subjektit, babai i bashkëshortit të subjektit dhe një mik i familjes, të cilët nëpërmjet huave, dhurimeve, kanë mundur krijimin e disa prej pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit kërkoj depozitimin e provave të reja për të mbështetur aftësinë financiare të personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

Nëpërmjet ankimit të depozituar iu kërkuar KPA-së riçelja e hetimit gjyqësor, duke realizuar një analizë të re financiare sa i përket personave të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit 3, pika 14 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit kërkoj riçeljen e hetimit gjyqësor, me synim depozitimin e provave të reja.

Rezulton se palët ndërgjyqëse janë njohur me dosjen gjyqësore, provat dhe parashtrimet e depozituara, konformë nenit 36 të ligjit nr. 49/2012. Sipas neneve F, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe 45 të ligjit 84/2016, me vendim të ndërmjetëm u vendos riçelja e hetimit gjyqësor dhe administrimi i provave të reja, të depozituara nga ana e subjektit. Gjithashtu, KPA vendosi marrjen e iniciativës për realizimin e një analize të re financiare, e mos trajtimin e 13 denoncimeve të ardhura nga publiku për shkak se janë të pabazuara në kriteret e rivlerësimit sipas nenit 53 të ligjit 84/2016.

KPA caktoi seancën e radhës më dt. 21 dhjetor 2022, ora 10:00.